



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 6381 /2026
Data: 13.07.2026

PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e gjashtë -VI- për vitin 2026 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më datë 18.06.2026, me fillim pune në orën 11:00, në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Sevdi Dernjani (Nënkryetar i Komunës), Abduraman Bushi (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), Lindita Ballazhi (Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa), Senad Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Ajete Berisha (Udhëheqëse e Personelit), Bashkim Sopa (Zyrtar për Transparencë).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Korniza afatmesme buxhetore 2027-2029.
3. Kërkesë për rialokim të mjeteve në kategorinë buxhetore të shpenzimeve kapitale.
4. Propozim-vendim për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2027.
5. Propozim-vendim për shfuqizimin e pjesshëm të vendimit të Kuvendit të Komunës Hani i Elezit me numër Nr. 3444/2013, të datës 27.06.2013, si dhe shfuqizimin e pjesshëm të vendimit me numër Nr. 2457/2023, të datës 30.03.2023.
6. Plani ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt.
7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson: Për pikat e rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlasi thekson: Për pikat e rendit të ditës nuk kam ndonjë vërejtje, por në këto gjashtë muaj që kemi funksionuar e kam analizuar shumë. Më funksionale do të ishte që mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa të mbahej në dhjetëditëshin e parë të muajit, në mënyrë që t'i jepej hapësirë ekzekutivit për vërejtjet të cilat i japim, propozimet që jepen, ndërsa në dhjetëditëshin e fundit të mbahej mbledhja e Kuvendit. Kërkoj që ky propozim të dalë në votim.

Kryesuesi thekson: Ata të cilët duan të ndryshojnë, nëse ka ndonjë vërejtje, ka kohë, pra shtatë ditë, deri në ditën kur mbahet mbledhja e Kuvendit të Komunës, por më e arsyeshme më duket të lihet diferencë, për shkak se ndoshta mund të kenë obligime. Propozimin e z. Menduh Vlasi e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte: 2 për, 3 kundër, pra nuk kalon propozimi. A keni edhe ndonjë diskutim? Nëse nuk ka, e hedh në votim rendin e punës. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin. Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Korniza afatmesme buxhetore 2027-2029

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson: Për çdo vit ne e pranojmë qarkoren buxhetore me kufijtë fillestarë të planifikimeve buxhetore. Gjatë kësaj periudhe formohet një grup pune për hartimin e këtij dokumenti kryesor për planifikimin e buxhetit dhe mbahen dëgjimet buxhetore nëpër komunitete të ndryshme, ku bëhen propozime nga qytetarët. Faza tjetër është hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore, si dhe hartimi i një drafti të Kornizës Afatmesme Buxhetore. Data e fundit e aprovimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore është tridhjetë qershori, dhe pastaj Korniza Afatmesme Buxhetore dërgohet në Departamentin e Buxhetit të Ministrisë së Financave. Burimet e financimit janë të njëjta sikurse për çdo vit: granti i përgjithshëm, granti specifik i arsimit dhe granti specifik i shëndetësisë, si dhe të hyrat vetanake komunale. Për vitin 2027 kemi një rritje të gjitha burimet e financimit dhe buxheti përfundimtar për vitin 2027 është katër pikë gjashtë milionë. Në Kornizën Afatmesme Buxhetore janë të shënuara të gjitha diferencat ndër vite dhe në vlera. Për vitin 2027, në sektorin e shëndetësisë i kemi shtatëmbëdhjetë pozita të aprovuara dhe gjashtë të tjera në sektorin e arsimit, por kjo nuk është finale, sepse finalja do të jetë kur të pranohet qarkorja e dytë buxhetore përfundimisht për vitin 2027, apo ndoshta do të ketë edhe ndryshime të tjera.

Medina Imishti thekson: Fillimisht po dua të di se pse jemi pjesë e grupit punues në këtë draft, se këtë e kam biseduar edhe me kolegët e tjerë dhe nuk kanë qenë pjesë e ndonjë takimi. Mendoj që nuk është dashur të na lënë aty, përderisa nuk kemi marrë pjesë në asnjë takim. Pse nuk është përcjellë lista e kërkesave që kanë dalë nga dëgjimet buxhetore? Është mirë të shohim se cilat kanë qenë kërkesat e qytetarëve dhe a janë përfshirë edhe ato në buxhet. Te ndarja e buxhetit e kam vërejtur se te kategoria e shpenzimeve kapitale është vetëm shtatëmbëdhjetë për qind e buxhetit dhe mendoj që nuk i është dhënë ndonjë prioritet i duhur kësaj kategorie buxhetore të investimeve, për shkak se janë investime të cilat e prekin direkt jetën e qytetarëve. Në vitin 2026 investimet kapitale kanë qenë mbi tetëqind mijë euro, ndërsa për vitin 2027 janë shtatëqind e nëntëdhjetë e katër mijë. Gjithashtu vërehet se është një rritje totale e buxhetit nga viti i kaluar, pra dhjetë për qind, duke e krahasuar me vitin 2026. Përkundër rritjes së buxhetit, pse ka më pak buxhet në investimet kapitale? Te plani afatmesëm i të hyrave për vitin 2027 planifikohen të jenë mbi katërqind mijë euro, e që, krahasuar me vitin 2026, në përqindje është tridhjetë e tetë për qind. Kërkoj të di se ku është kjo rritje dhe si e keni përshkruar. Te bashkëpagesat në arsim i keni planifikuar nga pesëmbëdhjetë mijë në njëzet e pesë mijë euro, meqë ne nuk e kemi ndryshuar rregulloren për taksa dhe tarifa. E njëjta është edhe te të hyrat e tjera, siç janë gjobat. Për vitin 2026 e keni pasur planifikimin zero euro, ndërsa për vitin 2027 janë planifikuar tetëdhjetë e pesë mijë euro.

Lindita Ballazhi thekson: Sa i përket grupit punues, keni të drejtë se nuk kemi mbajtur takime, por sot do ta diskutojmë kornizën afatmesme buxhetore komplet me anëtarët e grupit punues, si dhe do të kemi edhe takime të tjera derisa ta bëjmë një kornizë afatmesme buxhetore finale. Ne e kemi formuar një grup punues që t'i përfshijë të gjitha kërkesat, të cilat i kanë edhe qytetarët, por edhe nga këndvështrimi i juaj se si do të jetë buxheti për vitin 2027 dhe më anej. Shuma e projekteve kapitale është më e vogël për shkak të aprovimit të një numri shumë të madh në sektorin e shëndetësisë, se shtatëmbëdhjetë pozita janë aprovuar, dhe në arsim i kemi gjashtë pozita, kështu që pjesa më e madhe e buxhetit, fatkeqësisht, duhet të shkojë në kategorinë e pagave, obligimeve, të shpenzimeve komunale që janë për çdo muaj, mallra dhe shërbime. Te plani afatmesëm i të hyrave e kemi këtë rritje, se gjatë muajit mars nga Departamenti i Buxhetit e pranojmë një tabelë, ku aty ne i parashohim disa lloje të të hyrave se sa do të jenë për vitin e ardhshëm, gjithmonë duke u bazuar në trendin e inkasimit të të hyrave vetanake, dhe këtë projeksion e kam dërguar me një shumë më të vogël, mirëpo nuk e kanë marrë parasysh. Për disa lloje të të hyrave kemi ne të drejtë që t'i planifikojmë, por gjithmonë brenda asaj shume të përcaktuar nga Ministria e Financave. I kemi rritur bashkëpagesat në arsim, pasi që deri më tani nuk është diskutuar për ndonjë ndryshim të rregullores, sidomos të pagesave të participimeve në çerdhe, por kjo rritje është në bazë të inkasimit të cilin e kemi pasur deri më tani në participimet në çerdhe, që gjithmonë e tejkalojnë atë shumë, dhe e kemi paraparë që të ketë një rritje. Te gjrobat e kam lënë në atë mënyrë, sepse mendojmë që mundemi me i inkasuar, për shkak se bëjnë pjesë edhe të hyrat indirekte, gjrobat nga policia, që vit pas viti janë rritur dhe kemi një tejkalim të të hyrave vetanake.

Menduh Vlasi thekson: Vërejtje kam se nuk duhet të qitet emri i dikujt pa u konsultuar, pra le të mbetet hera e parë edhe e fundit që emri im keqpërdoret. Në faqen dhjetë e keni projeksionin e të hyrave vetanake, njëqind e tridhjetë e dy milionë, që nuk e kam kuptuar, pra a bëhet fjalë në nivel të Kosovës apo të Komunës.

Kryesuesi thekson: Te çështja e emrit, drejtoreshë, dy apo tri herë më ka kërkuar që kur po e mbajmë një takim me ju, por kam menduar që sot ta mbajmë Komitetin për Politikë e Financa dhe pastaj ta diskutojmë.

Lindita Ballazhi thekson: Sa i përket grupit punues, i kam vazhduar praktikën nga viti i kaluar, për shkak se me shefat e grupeve e kemi pasur grupin punues dhe çdo herë kemi mbajtur mbledhje dhe e kemi finalizuar kornizën afatmesme buxhetore, mirëpo për herët e tjera do ta kemi në konsideratë. Është makrofiskale dhe e përfshin nivelin qendror komplet, pra bëhet fjalë për tërë Kosovën.

Medina Imishti thekson: Ju potencuat që investimet kapitale janë në këtë vlerë që janë për shkak të buxhetit në paga dhe mëditje, se shtatëmbëdhjetë janë në sektorin e shëndetësisë të planifikuara dhe gjashtë në sektorin e arsimit, dhe nëse Ministria e ka lejuar rritjen e stafit, a nuk e ka rritur edhe buxhetin për atë sektor?

Lindita Ballazhi thekson: Në faqen nëntë, tabelën e shpërndarjes së granteve të shëndetësisë, te rreshti i tetë, te ndryshimi i stafit, që do të thotë është shtatëmbëdhjetë, dhe në bazë të Ligjit të Buxhetit për vitin 2026, totali i stafit është 46, që do të thotë shtatëmbëdhjetë është diferenca për vitin e ardhshëm. Totali i buxhetit për paga dhe shtesa për vitin 2027, në qoftë se e marrim një mesatare të pagës 996 euro, është 534,523.00 €, dhe nëse përfshihen edhe pozitat e tjera, 755,964.00 €. Granti për shëndetësi për vitin 2027 është 653, a neve na duhen 655 për paga, dhe ku mbesin mallrat, kapitalet në sektorin e shëndetësisë? Kështu që ne duhet me ndihmuar edhe me grant të përgjithshëm, me ndihmuar grantin e shëndetësisë. I kanë aprovuar si pozita dhe mund t'i lëmë si pozita nëse nuk kemi mundësi buxhetore, kështu që është dashur pak më shumë me planifikuar te pagat, por nuk mund të mbulohen të gjitha, normalisht, nëse nuk rekrutohen deri në janar.

Visar Hasallari thekson: Te përgatitja dhe hartimi i grupit punues është bërë një gabim teknik, sepse e dimë që shef i grupit parlamentar të PDK-së është z. Basri Dernjani dhe është mirë të ndryshohet. Te Zyra e Kryetarit të Komunës, në vitin 2027, te plani i ndarjeve buxhetore, shpenzimet totale për vitin 2027, te Zyra e Kryetarit të Komunës, subvencione dhe transfere janë 70,000 €, kurse për vitin 2028 është një ulje në shumë prej 50,000 €. Kërkoj sqarim për këtë çështje.

Lindita Ballazhi thekson: Gabimi teknik do të përmirësohet dhe sa i përket subvencioneve kemi një rritje, se kemi shumë kërkesa të lehonisë dhe jemi dëshmitarë që çdo herë duhet të marrim prej drejtorive të tjera për me i ekzekutuar pagesat për lehonitë, kërkesa për sëmundje të rënda që subvencionohen nga Zyra e Kryetarit të Komunës. Gjithashtu, nga Zyra e Kryetarit të Komunës subvencionohet Hendikos dhe disa aktivitete, që do të thotë kërkesat janë rritur vit pas viti dhe për atë arsye kemi kërkuar që kjo shumë të rritet. Përsëri do të kemi planifikime të tjera, por e kemi lënë në atë mënyrë.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2027–2029, QË T'I PËRCILLET KUVENDIT.

3. Kërkesë për rialokim të mjeteve në kategorinë buxhetore të shpenzimeve kapitale.

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson: Në kuadër të nënprogramit buxhetor zhvillimi ekonomik (48075), kodi funksional (0473), rialokohet në projektin Ndërtimi i tregut ditor në Han të Elezit, kodi (20976), shuma prej 17,550.00 €, rialokohen në projektin Rregullimi i hapësirave turistike në Han të Elezit dhe fshatrat: Pustenik, Krivenik, Seçishtë, Paldenicë, Gorancë, kodi (55046), në shumë prej 17,550.00 €. Po ashtu e kemi edhe disa projekte nga Drejtoria e Urbanizmit, që nga këto projekte do të rialokohen në projekte të tjera të bashkëngjitura në shkresë.

Menduh Vlasi thekson: Rialokimi a është bërë për shkak se nuk janë realizuar projektet? Dhe nëse nuk janë realizuar projektet, kërkoj nga ekzekutivi i komunës që planifikimet t'i bëjë mirë dhe atë projekt që e keni futur me realizuar, ta realizoni, për arsye se kjo është mashtrim i qytetarëve. Ju në debat publik potenconi që ka me u rregulluar tregu, pastaj me Komitet dhe Kuvend e rialokoni diku tjetër dhe kjo është mashtrim i qytetarëve. Rialokimi mund të bëhet nëse një projekt është planifikuar të kushtojë njëqind mijë euro dhe ka kushtuar tetëdhjetë mijë euro, që do të thotë njëzet mijë euro kanë mbetur dhe pjesa e mbetur mund të rialokohet me ndonjë projekt tjetër, e jo me ndërruar tërë projektin.

Nexhmedin Daci thekson: Problemi është se kur hartohet buxheti, dy apo tri ditë para miratimit propozohen projekte kapitale. Rastin konkret e kemi te kjo rruga për Vërtomicë, që është miratuar në Kuvend si projekt për këtë vit, por janë ndarë vetëm 30,000 €, ndërsa kur është hartuar projekti, kostoja e projektit ka dalë 300,000 €, që do të thotë për arsye financiare është e pamundshme me realizuar atë projekt. Ngjashëm është edhe me projektet e tjera dhe mjete për bashkëinvestime i kemi ndarë dhjetë mijë euro, sepse ka pasur premtime me IPA fondet. Projekti i rrugës Seçishtë–Vorba, 98,000 €, ka dalë kostoja për me realizuar këtë projekt, e që ne nuk i kemi as 20% të këtyre mjeteve. Ne kemi pasur premtime prej Qeverisë për rrugën e Vërtomicës dhe për projekte të tjera, mirëpo këto zgjedhje e kanë bërë të vetën, për shkak se gati për çdo vit Ministria na ka ndihmuar dhe në këtë vit nuk ka shenja që do të na ndihmojë në projekte kapitale. Në këtë vit, për mos me na mbetur projektet, i kemi bartur në projekte të tjera kapitale dhe ato projekte kanë dalë më shtrenjtë se sa janë ndarë mjetet gjatë buxhetimit. Kështu që nuk duhet me qenë problem, për shkak se këto projekte mbesin në listë të projekteve për vitin e ardhshëm dhe pastaj varet prej Kuvendit se cilit projekt i jep prioritet. Çështja e projektit të tregut ndërlihet me shpronësimin. Ne pjesën tonë e kemi përfunduar, kërkesa është në Ministri dhe komisioni duhet me vlerësuar, por ende nuk janë paraqitur dhe nuk i di arsyet dhe nuk mundem me i detyruar.

rruga para komunës me u mbyllur. Nëse mbetet rruga, ka pjesa tjetër, atëherë nuk ka me pasur hapësirë për treg, për shkak se rruga duhet me u zgjeruar.

Menduh Vlasi thekson: Mos i fut në listë projektet prioritare me shumë dhjetë mijë euro, se e di që nuk kryhen. Potenconi se kemi pasur shpresë nga Ministria, po ato mjete futini me një projekt me bashkëinvestime. Mos e fut rrugën Gorancë – Krivenik më shumë se njëzet mijë euro dhe ju potenconi se shpresojmë prej Ministrisë, por fute te bashkëinvestimet dhe sa dush mjete financiare dediko aty. Mundeni me potencuar se i kemi dedikuar këto mjete për shkak se shpresojmë që Ministria me na i financuar këtë projekt. Mirëpo, ju i keni futur disa projekte për vitin e ardhshëm me nga dhjetë mijë apo pesëmbëdhjetë mijë, që shumica nuk kryhen. Projektin e tregut e kuptoj, për shkak se nuk është kryer shpronësimi, por jo rrugën e Neqafcit apo Vorbave, që donë të thotë barten mjetet nga rruga e Vorbave për në Llok. Çfarë kuptimi ka kjo? Kërkoj që lista e projekteve prioritare për vitin 2027 mos të dalë me kesi gabime, sepse për projektin duhet të dihet përafërsisht se sa mjete financiare shkojnë. Kemi plot projekte, që do të flas në Kuvend, shtrimi me kupëza që nuk dihet ku, pastaj rregullimi i kanalizimit që nuk dihet ku, e që unë do të jem kundër këtyre projekteve, por duhet të jetë saktë projekti se në cilën rrugë do të jetë.

Nexhmedin Daci thekson: Asnjë pikë të cilën e potenconi nuk qëndron kështu. E para e punës, po më vjen shumë keq se Drejtoria e Urbanizmit nuk e miraton buxhetin dhe as listën e projekteve, sepse ekzekutivi del me projekte dhe ato miratohen. Mirëpo, problemi qëndron se, kur të miratohet buxheti në mbledhje, ipen propozime dhe kalojnë, por atë ditë nuk i kam projektet dhe paramasat gati se sa do të kushtojë projekti. Shembull konkret është projekti rruga Rezhancë te varrezat. Nuk e di sa mundet me kushtuar, por ju e keni propozuar dhe e keni miratuar, dhe i keni ndarë njëzet mijë euro. E keni prezent nënkryetarin e komunës, i cili ka pasur premtime serioze prej Ministrisë së Infrastrukturës për projekte të caktuara, por kanë ndodhur zgjedhjet, se edhe ai ministër apo zëvendësministër nuk ka mundur me i paraparë. Në i heqim projektet të gjitha, por për çdo vit Ministria e Zhvillimit Rajonal ka ndarë mjete, dhe atëherë cilin projekt me ia dhënë nëse nuk i heqim? Sa i përket rrugicave, ne e dimë, sepse i marrim kërkesat e qytetarëve. Del komisioni në terren e shikon gjendjen faktike të rrugicës. Është si kod shtrimi i rrugicave me kupëza betoni, sepse ka rrugicë e cila kushton tre mijë euro dhe mi paraqitë dhjetë rrugica e rëndon listën e projekteve dhe zyrën e prokurimit, për shkak se, në vend të një procedure të prokurimit, duhesh dhjetë procedura mi shpall.

Sevdi Dernjani thekson: Për shkak të kontratës kolektive, ju e dini shumë mirë, shumë pengesa kemi pasur në projekte. Janë marrë vendime në qeverisjet e kaluara që sot i kemi pasojat. Janë diku shtatëqind e pesëdhjetë mijë euro që keni marrë vendim në qeverisjet e kaluara për shpronësimin e parcelave te fabrika e ujit, te Shtëpia e Kulturës, te fusha e sportit, dhe AKP-ja na i bie faturën shtatëqind e pesëdhjetë mijë euro. E ty këto planifikime që je duke i bërë këtu, a e din që AKP-ja mundet mi marrë mjetet dhe vitin e ardhshëm asnjë projekt mos me mundur me bërë? Po besoj që jemi të vetëdijshëm për veprimet të cilat i kemi marrë në të kaluarën, pra prej legjislativit të mëhershëm, ekzekutivit të mëhershëm. Pra, janë vendime që ne i kemi pasojat. Janë diku përmbi një milion euro që ne kemi kryer obligime dhe kemi me kryer. I nderuar z. Menduh Vlasi, këto projekte të cilat i kemi këtu janë të planifikuara. Nuk kemi me ditur saktë se cilin projekt kemi me kryer. Drejtori potencon që i kemi ndarë pesëdhjetë mijë euro. Unë i kam thënë se është mirë për këtë rrugë, për shkak se kemi premtime prej ministrit se ka me ma kryer këtë rrugë dhe ne nuk mundemi me planifikuar se ai ministër nuk ka me qenë dhe nuk ka me shprehur gatishmëri me të mbështetur. Për këto arsye bëhen këto planifikime dhe ndahen mjete, për arsye që me pasur projektin sa më serioz.

Menduh Vlasi thekson: Është mirë me hequr sloganin "qeveritë e kaluara", por qeveria e kaluar vetëm vitin e parë mundet me të dëmtuar, sepse e ka bërë buxhetin. Ti e planifikon buxhetin dhe nuk ka lidhje qeveria e kaluar, se e ke ditë saktë i ke borxh arsimin apo tjerëve, por plot projekte me dhjetë mijë, njëzet mijë dhe asnjë nuk kryhet. Më mirë është pesë projekte mi futë dhe mi kryer, për arsye se ju vetë keni me dalë keq, për shkak se prej njëzet projekteve i keni realizuar dhjetë, pra pesëdhjetë për qind.

Senad Kalisi thekson: Sa i përket rialokimit të mjeteve, kërkesë kam dy kodet të cilat i kam të barten te kodi i riparimit të rrugëve dhe trotuareve: rregullimi i krojeve publike në Han të Elezit dhe fshatrat përreth, projekti për ngritjen e deponisë për mbetjet inerte, pra të bartet te riparimi i rrugëve dhe trotuareve.

Medina Imishti thekson: Kërkoj nga Drejtoria e Financave që këtij dokumenti, para miratimit, me ia bashkëngjitur një listë në Excel për projektet të cilat janë realizuar, sa është mbetja, sa është buxheti në projektet që po rialokohen.

Nexhmedin Daci thekson: Nuk bëhet fjalë për projektet e realizuara, sepse nuk ka filluar për me u realizuar ende, por fjala është për listën e projekteve e cila është miratuar në Kuvend. Për do projekte prej kësaj liste nuk kemi me mundur me i realizuar, për shkak se shuma e projekteve është shumë më e madhe dhe ato mjete kemi me i bartur në projekte të tjera.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA KËRKESA PËR RIALOKIM TË MJETEVE NË KATEGORINË BUXHETORE SHPENZIME KAPITALE, QË T'I PËRCILLET KUVENDIT.

4. Propozim-vendim për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2027.

Kryesuesi thekson: Propozoj që për anëtarë të komisionit të jenë anëtarët e Komitetit për Politikë e Financa. Nëse keni ju ndonjë propozim, mund të parashtroni. Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA PROPOZIM-VENDIMI PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2027, QË T'I PËRCILLET KUVENDIT.

5. Propozim-vendim për shfuqizimin e pjesshëm të vendimit të Kuvendit të Komunës Hani i Elezit me numër Nr. 3444/2013, të datës 27.06.2013, si dhe shfuqizimin e pjesshëm të vendimit me numër Nr. 2457/2023, të datës 30.03.2023.

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson: Fjala është për dy vendime. Njëri ka të bëjë me vitin 2013 dhe tjetri me vitin 2023, për shfuqizim të pjesshëm të pikave të caktuara. Pra, bëhet fjalë për njëmbëdhjetë parcela, të cilat menaxhohen prej Agjensionit Kosovar të Privatizimit. Unë kam biseduar me ata dhe na kanë sugjeruar që na me bërë shfuqizimin e këtyre parcelave, në mënyrë që AKP-ja në Gjilan me iu drejtuar Gjykatës dhe me kërkuar që AKP-ja me hequr dorë prej këtyre parcelave, dhe pastaj me automatizëm ato bëhen parcela të komunës.

Menduh Vlasi thekson: Materialin e kësaj pike të rendit të ditës e kam lexuar, po më është dukur shumë i paqartë. Me dokumentacion je i qartë, po ngjyra bardh e zi nuk i disha se ku janë dhe do të ishte mirë që parcelat me numër dhe me përshkruar se ku, për me ditë se ku është. Është mirë që për Kuvend me na i sqaruar. Ky propozim-vendim po më duket shumë i dyshimtë, se na në vitin 2013 e kemi marrë këtë vendim, dhe në vitin 2023 pikërisht, që mos me ia lanë AKP-së me i shitur, por me mbetur si prona komunale, pra në interes të komunës, dhe tash ne po heqim dorë me ia lënë AKP-së në mëshirë se a ia lë komunës apo i shet. Unë kam dyshuar dhe dyshoj që dikush ia ka vendosur syrin ndonjë parcele dhe tash duhet me i kryer këto procedura dhe me ia lënë AKP-së, dhe AKP-ja e qet në shitje, dhe personi e blen. Është interes i komunës që me pasur sa më shumë prona, e ne po heqim dorë, por unë do të jem kundër.

Visar Hasllari thekson: Kohët e fundit kemi dalë me ecë dhe po e shoh që një pjesë e madhe e qytetit është në terr. Kërkoj sqarim se deri ku kanë mbërri procedurat dhe kur pritet me u rregulluar.

Senad Kalisi thekson: Mirëmbajtja e ndriçimit publik i ka kaluar të gjitha fazat, është shpallur fituesi dhe po presim që shumë shpejt të fillojnë punimet.

Kryesuesi thekson: A keni ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 12:17.

Procesmbajtësi

Ayni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit

Florim Shkreta

